



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 137/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për apelin e Ergyn Dobërçani, lidhur me tërheqjen nga lista e e kandidateve të certifikuar për Anëtar të Kuvendit të Komunës në Prishtinë, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi, (KDTP), për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si i palejueshëm apeli i Ergyn Dobërçani, kandidat për Anëtar të Kuvendit të Komunës në Prishtinës, nga subjekti politik KDTP .

Arsyetim

PZAP, me datën 02.10.2013, ka pranuar një apel nga Ergyn Dobërçani, kandidat për anëtarë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nga subjekti politik KDTP, në të cilin apel parashtron kërkesën për tërheqje nga lista e kandidateve për anëtar të Kuvendit të Komunës në Prishtinë, nga subjekti politik KDTP, me arsyetimin se tërheqjen e bën për arsye personale.

PZAP-i, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka rikualifikuar si apel duke u bazuar në nenin 1 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, dhe gjeti se:

apeli është i palejuar

Tërheqja e një kandidati nga listat e kandidateve të certifikuar nga një subjekt politik ose nga vet kandidati është e rregulluar me LZP konkretisht me nenin 28.1 të LZP-së, ku dispozitat ligjore përcaktojnë që subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar kërkesën KQZ-së për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit.

KQZ-ja me datën 19.09.2013, e ka hedhur shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotime për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013. Nga kjo del se parashtruesi i apelit ka pas të drejtë që deri më datë 17.09.2013, të parashtron kërkesë në KQZ për të u tërhequr nga lista e kandidatëve të certifikuar të cilën të drejtë pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar, që ja mundëson neni 28.5 i LZP-së. PZAP-i nga kjo konstatoi se pala ankuese nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e lartcekur për tërheqje nga lista e kandidatëve të certifikuar por ka parashtruar drejtpërdrejt apel në PZAP, gjë që nuk është e lejuar sipas LZP-së, andaj duke u bazuar në arsyet e lartcekura PZAP-i dhe ne kuptim të nenit 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 137/2013 më datën 03.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*